



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 19 (paragrafi 11) të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit (nr.01/2014), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.06.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-2026-14 për z. Etor Hoxha – *Ish Drejtor i Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës për shkak se nuk ekziston gjendja faktike e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-2026-14, për ish zyrtarin e lartë, z.Etor Hoxha-ish Drejtor i Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar pas informatës së marrë, sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Z.Etor Hoxha, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtaret e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është kuptuar se tashmë ish zyrtari i lartë ztr. Hoxha nuk e ushtron me funksionin e Drejtorit i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Gjakovës, e po ashtu nuk ka asnjë funksion tjetër publik.

Prandaj, ushtrimi i funksionit të pronarit dhe parasëgjithash i personit të autorizuar të biznesit privat, "Prosol" L.L.C. tashmë nuk paraqet konflikt faktik të interesit, ndërsa duhet të parandalohet ndonjë situatë eventuale e konfliktit "rast për rast" të interesit që mund të shfaqej ne lidhje me ish funksionin e tij të mëparshëm publik.

II. Në mbështetje të nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

